



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 2

Tiranë – E enjte, 4 janar 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 28.12.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 337, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit të parqeve teknologjike dhe shkencore”... 107
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 16, datë 20.12.2023	Për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve..... 109
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 322, datë 14.11.2023	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k., si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve..... 118
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 323, datë 14.11.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.3.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sun Avenue’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw” 119
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 324, datë 14.11.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.3.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sunpower 2017’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw” 120
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 354, datë 1.12.2023	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi” 121
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 357, datë 1.12.2023	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k..... 123
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar “Sekret shtetëror” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave..... 124
	Kërkesë për shpalljen e zhdukjes së shtetasit Anton Preni..... 128



VENDIM

Nr. 835, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 337, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË ZHVILLUESIT TË PARQEVE TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të nenit 7, të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 337, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit të parqeve teknologjike dhe shkencore”, bëhen këto shtesa:

1. Në nenin 2, pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Procedurë jokonkurrese për përcaktimin e zhvilluesit: institucion i qeverisjes qendrore, njësi e vetëqeverisjes vendore apo shoqëri shtetërore me kapital shtetëror/ent publik, të cilët, sipas legjislacionit në fuqi, mund të jenë zhvillues edhe të zonës teknologjike të zhvillimit ekonomik.”.

2. Pas nenit 23 shtohen nenet 23/1, 23/2 dhe 23/3, me këtë përmbajtje:

“Neni 23/1

Procedura jokonkurrese për përcaktimin e zhvilluesit: institucion i qeverisjes qendrore, njësi e vetëqeverisjes vendore apo shoqëri shtetërore me kapital shtetëror/ent publik

1. Këshilli i Ministrave, në vendimin për hapjen e parkut ose në një vendim të posaçëm, miraton autorizimin e institucionit të qeverisjes qendrore, njësisë së vetëqeverisjes vendore apo shoqërisë shtetërore me kapital shtetëror/ent publik, në rolin e zhvilluesit të parkut.

Propozimi bëhet nga ministria përgjegjëse për ekonominë pas kërkesës së argumentuar të institucionit të qeverisjes qendrore, njësisë së

vetëqeverisjes vendore apo shoqërisë shtetërore me kapital shtetëror/ent publik.

2. Në vendimin e parashikuar, sipas pikës 1, të këtij neni, Këshilli i Ministrave mund t'i caktojë një afat zhvilluesit të autorizuar për paraqitjen e planit të zhvillimit të detajuar, plan i cili përfshin edhe elementet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 4, të nenit 3, të këtij vendimi, si dhe kapacitetet financiare, shoqëruar me draftmarrëveshjen, ku parashikohen angazhimet reciproke të palëve, sipas pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 58/2022.

3. Ministria përgjegjëse për ekonominë, pas vlerësimit të planit të zhvillimit të detajuar dhe draftmarrëveshjes së paraqitur, i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e tyre së bashku me kontratën e qirasë për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore.

Neni 23/2

Procedura e përzgjedhjes së menaxhuesit/administruesit të parkut nga zhvilluesi i autorizuar

1. Zhvilluesi i autorizuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, ka të drejtë të përzgjedhë menaxhues/administrues të parkut, të cilët mund të jenë persona juridikë privatë ose publikë, si dhe institucione të arsimit të lartë.

2. Zhvilluesi i autorizuar, në bashkëpunim me menaxhuesin/administruesin, siguron përmbushjen e kushteve të nevojshme për zhvillimin dhe menaxhimin e parkut, ku, në çdo rast, zhvilluesi i autorizuar mbetet përgjegjës për detyrimet e tij ndaj institucionit përgjegjës dhe organeve shtetërore.

3. Zhvilluesi i autorizuar përzgjedh menaxhuesin /administruesin nëpërmjet procedurës konkurrese me negociim, me dy faza, përkatësisht faza e kualifikimit dhe faza e negociimit.

4. Rregullat për procedurën e konkurrimit, përfshirë procedurën e ankimimit, përcaktohen me akte të brendshme të zhvilluesit të autorizuar dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të tij përpara publikimit të ftesës për shprehje interesi.

5. Zhvilluesi i autorizuar, në fazën e parë, kualifikon kandidatët, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrje, bazuar në parashikimet e nenit 23/3, të këtij vendimi. Vendimi i kualifikimit për kandidatët që plotësojnë këto kritere është i vlefshëm për një afat deri në 9 (nëntë) muaj nga dita



e njoftimit të aplikantëve fitues të kësaj faze. Faza e dytë, negociimi, zhvillohet me kandidatët e kualifikuar, të cilët thirren për të paraqitur propozimet. Procedura vijon edhe nëse kualifikohet vetëm një kandidat.

6. Zhvilluesi i autorizuar, pas vlerësimit të propozimeve të kandidatit/kandidatëve dhe miratimit të subjektit fitues, kryen procesin e negociimit të kontratës së menaxhimit/ administrimit.

7. Kontrata e menaxhimit/administrimit nënshkruhet nga organi më i lartë ekzekutiv i zhvilluesit të autorizuar apo personi i autorizuar prej tij.

8. Shpenzimet për mbulimin e kostove për procedurat e publikimit, hartimit të dokumentacionit dhe konsulentëve të specializuar mund të përballohen nga kandidati/subjekti fitues, sipas përcaktimeve në thirrje.

Neni 23/3

Kriteret e kualifikimit dhe kriteret e përzgjedhjes së menaxhuesit/administruesit

Menaxhuesi/administruesi i një parku teknologjik përzgjidhet sipas procedurës konkurruese të përcaktuar në nenin 23/2, pasi plotëson kriteret e mëposhtme:

1. Kriteret ligjore/administrative/financiare/teknike:

a) nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

b) nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

c) kapitalet dhe asetet nuk janë objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm nga ana e shërbimit përmbartimor;

ç) i ka përmbushur rregullisht detyrimet në lidhje me pagesat e taksave dhe të tatimeve;

d) i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore;

dh) ka stabilitet ekonomik/kapacitet financiar për financimin e zhvillimit/menaxhimit të parkut;

e) vetë apo nëpërmjet nënkontraktuesve siguron eksperiencë në projekte të ngjashme në lidhje me zhvillimin dhe/ose menaxhimin e një parku teknologjik;

ë) paraqet planin e zhvillimit të detajuar/menaxhimit të parkut, i cili përfshin, ndër të tjera,

vlerën e investimit, burimin dhe mënyrën e financimit, listën e përdoruesit potencial, rolin specifik të një universiteti, planbiznesin, partneritete të mundshme, grafikun, fazat dhe afatet e ekzekutimit të investimeve për zhvillimin e parkut, vlerësimin e ndikimit social, ekonomik, mjedisor e strategjik të projektit dhe strukturën organizative të drejtimit.

2. Kriteri i përzgjedhjes

Kriteret përzgjedhëse janë vlera e investimit, përdoruesit potencialë apo çdo kriter tjetër, sipas përcaktimit në thirrje. Në rast se përdoret më shumë se një kriter vlerësimi, për renditjen e kandidatëve do të përdoret një sistem pikëzimi i kriterëve. Kandidati i renditur i pari do të jetë kandidati fitues.

3. Dokumentacioni që vërteton:

3.1 plotësimin e kriterit teknik:

a) plani i zhvillimit i detajuar/menaxhimit të parkut, në përputhje me shkronjën “ë”, të pikës 1, të këtij neni;

b) vetëdeklarim për:

i. plotësimin e kriterit për punime të ngjashme të realizuara dhe të përfunduara/eksperiencë në menaxhimin/funksionimin e parqeve teknologjike vetë ose në bashkëpunim me partnerët përkatës;

ii. sigurimin e licencave profesionale, që lidhen me kryerjen e punimeve, sipas objektit të kontratës;

iii. sigurimin e kualifikimeve arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punimeve/menaxhim;

iv. dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të ofertuesit apo të partnerëve të tij;

v. pajisje me mjete, pajisje teknike, që mund të vihen në dispozicion të kandidatit/ofertuesit për të përmbushur kontratën.

3.2 Plotësimin e kriterit financiar:

a) kopje të certifikuara të bilanceve të një ose më shumë viteve, të paraqitura nga autoritetet përkatëse dhe raporteve të auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi;

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore;

c) sigurimin e ofertës të përcaktuar në thirrje, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

3.3 Plotësimin e kriterit ligjor:

a) vërtetim që subjekti nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

b) vërtetim që subjekti nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;



c) ekstrakt historik i personit juridik, lëshuar nga autoriteti kompetent.

4. Subjektet, të cilat paraqiten në konkurrim, duhet të paraqesin dokumentet në format dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar. Subjektet e huaja duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ofertuesi duhet të vetëdeklarojë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. Në çdo rast, institucioni përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga ofertuesi, si më sipër, ose t'i kërkojë ofertuesit sqarime dhe dokumente mbështetëse.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 16, datë 20.12.2023

PËR SHËRBIMET PUBLIKE TË
TRANSPORTIT RRUGOR TË
UDHËTARËVE¹

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 70 të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”; ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar; ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar; vendimit nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”; vendimit nr. 513, datë 4.9.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”; dhe në përputhje me udhëzimin e ministrit të Financave

dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë se si në përputhje me rregullat e së drejtës të ushtrimit të veprimtarisë, autoritetet përgjegjëse mund të veprojnë në fushën e transportit publik të udhëtarëve për të garantuar ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm, të cilat janë ndër të tjera më të shumta, më të sigurta, me cilësi më të mirë ose me kosto më të ulët se sa ato që do të ishin mundësuar vetëm nga forcat e tregut.

2. Për këtë qëllim, udhëzimi përcakton kushtet sipas të cilave autoritetet përgjegjëse, kur vendosin ose kontraktojnë detyrimet e shërbimit publik, kompensojnë operatorët e shërbimit publik për kostot e pësuar/shpenzimet e kryera dhe/ose japin të drejta ekskluzive në këmbim të kryerjes së detyrimeve të shërbimit publik.

3. Ky udhëzim zbatohet për shërbimin kombëtar (ndërqytetës), përfshirë edhe në territorin përkatës të njërive të vetëqeverisjes vendore (qytetës, rrethqytetës dhe/ose ndërqytetës, në rastet kur është në përgjegjësi të bashkive përkatëse) dhe ndërkombëtar të shërbimeve të transportit rrugor publik të udhëtarëve, me përjashtim të shërbimeve që ofrohen kryesisht për interesin e tyre historik ose vlerën e tyre turistike.

4. Në varësi të marrëveshjes së autoriteteve përgjegjëse të njërive të vetëqeverisjes vendore, në territorin e të cilëve ofrohen shërbimet, detyrimet e shërbimit publik mund të kenë të bëjnë me shërbimet e transportit rrugor publik, duke përfshirë ato që mbulojnë nevojat e transportit vendor, brenda territorit të një bashkie dhe/ose në nivel qarku, si dhe në nivel ndërkufitar.

5. Ky udhëzim nuk zbatohet për koncesionet e punëve publike në kuptimin e legjislacionit për prokurimin nga organet/operatorët, që operojnë në transport dhe prokurimin publik.

¹ Ky udhëzim është përafëruar, pjesërisht, me rregulloren (KE) nr. 1370/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, 23 tetor 2007, lidhur me shërbimet publike të transportit hekurudhor dhe rrugor të udhëtarëve, që

shfuqizon rregulloret (EEK) nr. 1191/69 dhe (EEK) nr. 1107/70 të Këshillit dhe e ndryshuar nga Rregullorja (BE) 2016/2338 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 dhjetor 2016.



Neni 2 Përkufizime

1. Për qëllimet e këtij udhëzimi:

a) “transport publik i udhëtarëve” nënkupton shërbimet e transportit rrugor të udhëtarëve kombëtar dhe ndërkombëtar, me interes të përgjithshëm ekonomik, që i ofrohen publikut bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe vazhdimësisë;

b) “autoritet përgjegjës” nënkupton çdo autoritet publik, grup i autoriteteve publike ose çdo organ i ngarkuar me autoritet të tillë, që ka kompetencën për të ndërhyrë në transportet publike të udhëtarëve;

c) “autoritetet vendor përgjegjës” nënkupton çdo autoritet të vetëqeverisjes vendore, që ushtron kompetencën brenda një zone të caktuar gjeografike;

d) “operator i shërbimit publik” nënkupton çdo subjekt, ndërmarrje apo grup i ndërmarrjeve publike ose private, që operon në shërbimet publike të transportit të udhëtarëve ose çdo organizëm publik, që ofron shërbimet publike të transportit të udhëtarëve;

e) “detyrim i shërbimit publik” nënkupton kërkesën e përkufizuar ose të përcaktuar nga një autoritet përgjegjës, me qëllim garantimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm për transportin e udhëtarëve, që një operator, në rast se konsideron interesat e tij tregtarë, nuk i merr përsipër ose nuk do t’i merrte përsipër në të njëjtën masë ose në të njëjtat kushte pa shpërblim;

f) “e drejtë ekskluzive” nënkupton të drejtën që i jepet një operatori të shërbimit publik për të operuar disa shërbime publike të transportit udhëtarëve në një linjë, një rrjet ose në një zonë të caktuar, duke përjashtuar çdo operator tjetër të shërbimit publik;

g) “kompensim i shërbimit publik” nënkupton çdo përfitim, financiar ose jofinanciar, të dhënë nga fondet publike, në mënyrë direkte ose indirekte nga një autoritet përgjegjës gjatë një periudhe të zbatimit të një detyrimi të shërbimi publik ose në lidhje me atë periudhë;

h) “dhënie direkte” nënkupton dhënien e një kontrate të shërbimit publik një operatori të caktuar pa ndonjë procedurë paraprake konkurruese tenderimi;

i) “kontratë e shërbimit publik” nënkupton një ose më shumë akte juridike detyruese që konfirmojnë marrëveshjen midis një autoriteti

përgjegjës dhe një operatori të shërbimit publik, me qëllim për t’i besuar këtij operatori të shërbimit publik menaxhimin dhe operimin e shërbimeve publike të transportit të udhëtarëve, që u nënshtrohen detyrimeve të shërbimeve publike. Kontrata, gjithashtu, mund të jetë një vendim i marrë nga autoriteti përgjegjës, që:

- merr formën e një akti ligjor apo rregullator individual; ose

- përmban kushte, në të cilat vetë autoriteti përgjegjës ofron shërbime ose ia beson ofrimin e shërbimeve të tilla një operatori të brendshëm;

j) “operator i brendshëm” nënkupton një entitet juridikisht të veçantë, mbi të cilin një autoritet vendor përgjegjës, ose në rastin e një grupi autoritetesh, të paktën një autoritet vendor përgjegjës, ushtron kontroll të ngjashëm me atë të ushtruar mbi departamentet e veta;

k) “vlerë” nënkupton vlerën e një shërbimi, një linje, një kontrate të shërbimit publik ose një skeme kompensimi për transportin publik të udhëtarëve, që i korrespondon shpërblimit total, pa TVSH-së, të operatorit ose të operatorëve të shërbimit publik, duke përfshirë kompensimin e çfarëdo lloji të dhënë nga autoritetet publike dhe të ardhurat nga shitja e biletave të transportit, të cilat nuk i kthehen autoritetit përgjegjës në fjalë;

l) “rregull e përgjithshme” nënkupton masën që zbatohet pa diskriminim për të gjitha shërbimet publike të transportit të udhëtarëve të të njëjtët lloj, në një zonë gjeografike të caktuar, në të cilën një autoritet përgjegjës është përgjegjës;

m) “shërbime të integruara të transportit publik të udhëtarëve” nënkupton shërbimet e transportit të ndërlidhura brenda një zonë gjeografike të përcaktuar me një shërbim të vetëm informimi të skemës së biletave dhe të orareve.

Neni 3

Specifikimi i detyrimeve të shërbimit publik

1. Autoriteti përgjegjës do të përcaktojë specifikimet për detyrimet e shërbimit publik në ofrimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve dhe fushën e zbatimit të tyre në përputhje me nenin 2(e). Kjo përfshin mundësinë e grupimit të shërbimeve, që mbulojnë koston me shërbime të cilat nuk mbulojnë koston.

2. Gjatë përcaktimit të këtyre specifikimeve dhe fushëveprimit të zbatimit të tyre, autoriteti përgjegjës



respekton, siç duhet parimin e proporcionalitetit, në përputhje me të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë. Specifikimet duhet të jenë në përputhje me objektivat e politikave të deklaruara në dokumentet e politikave të transportit publik në fuqi. Përmbajtja dhe formati i dokumenteve të politikave të transportit publik dhe procedurat për konsultimin me palët përkatëse të interesuara do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin kombëtar.

3. Specifikimet e detyrimeve të shërbimit publik dhe kompensimi përkatës i efektit financiar neto të detyrimeve të shërbimit publik do të:

a) arrijnë objektivat e politikës së transportit publik në një mënyrë me kosto efektive; dhe

b) mbështesin financiarisht ofrimin e transportit publik të udhëtarëve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në politikën afatgjatë të transportit publik.

Neni 4

Kontratat e shërbimit publik dhe rregullat e përgjithshme

1. Kur një autoritet përgjegjës vendos t'i japë operatorit të zgjedhur prej tij një të drejtë ekskluzive dhe/ose një kompensim të çfarëdo lloji, në këmbim të realizimit të detyrimeve të shërbimit publik, duhet ta bëjë këtë sipas një kontrate shërbimi publik.

2. Pavarësisht përjashtimit nga pika 1, detyrimet e shërbimit publik, të cilat kanë për qëllim të vendosin tarifa maksimale për të gjithë udhëtarët ose për disa kategori udhëtarësh mund të bëhen, gjithashtu, objekt i rregullave të përgjithshme. Në përputhje me parimet e vendosura në nenin 5, në nenin 7 dhe në aneksin 1, autoriteti përgjegjës kompenson operatorët e shërbimeve publike për efektin financiar neto, pozitiv apo negativ, mbi shpenzimet e bëra dhe të ardhurat e gjeneruara, në përputhje me detyrimet tarifore të hartuara nëpërmjet rregullave të përgjithshme, me qëllim që të shmangët çdo mbikompensim, pa marrë parasysh të drejtën e autoriteteve përgjegjëse për të integruar detyrimet e shërbimit publik, që vendosin tarifat maksimale në kontratat e shërbimit publik.

3. Autoriteti/et përgjegjës/e mund të përjashtojnë nga fusha e zbatimit të këtij udhëzimi rregulla të përgjithshme për kompensimin financiar për detyrimet e shërbimit publik, të cilat përcaktojnë tarifa maksimale për nxënësit, studentët, praktikantët dhe personat me aftësi/lëvizshmëri të

kufizuara. Këto rregulla të përgjithshme do të njoftohen/bëhen me dije në përputhje me kuadrin ligjor për informimin publik. Çdo njoftim i tillë duhet të përmbajë informacion të plotë mbi masën dhe, në veçanti, detaje mbi metodën e llogaritjes.

Neni 5

Përmbajtja detyruese e kontratave të shërbimit publik dhe rregullat e përgjithshme

1. Kontratat e shërbimit publik dhe rregullat e përgjithshme do të:

a) përcaktojnë qartë detyrimet e shërbimit publik, të përcaktuara në këtë udhëzim dhe të specifikuara në përputhje me nenin 3 të tij, me të cilat operatori i shërbimit publik duhet të pajtohet, dhe zonat gjeografike përkatëse;

b) vendosin paraprakisht, në mënyrë objektive dhe transparente:

i. parametrat mbi bazën e të cilëve do të llogaritet pagesa e kompensimit, nëse ka; dhe

ii. natyrën dhe shtrirjen e çdo të drejte ekskluzive të dhënë, në një mënyrë që parandalon mbikompensimin.

c) përcaktojnë modalitetet e ndarjes së kostove që lidhen me ofrimin e shërbimeve. Këto kosto mund të përfshijnë, veçanërisht, kostot e personelit, të energjisë, të infrastrukturës, të mirëmbajtjes dhe të riparimit të mjeteve të transportit publik, të mjeteve lëvizëse dhe të instalimeve të nevojshme për funksionimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve, kostot fikse dhe një kthim të përshtatshëm të kapitalit.

2. Kontratat e shërbimit publik dhe rregullat e përgjithshme përcaktojnë modalitetet e shpërndarjes së të ardhurave nga shitja e biletave të udhëtimit, të cilat mund të mbahen nga operatori i shërbimit publik, t'i jepen autoritetit përgjegjës apo të ndahen midis tyre.

3. Në rastin e kontratave të shërbimeve publike që nuk jepen sipas nenit 6, pikat 1, 3 ose 4b, këta parametra do të përcaktohen në mënyrë të tillë që asnjë pagesë kompensimi të mos kalojë shumën e kërkuar për të mbuluar efektin financiar neto në kostot e bëra dhe të ardhurat e krijuara në përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, duke marrë parasysh të ardhurat që lidhen me to të mbajtura nga operatori i shërbimit publik dhe një fitim të arsyeshëm;



4. Kohëzgjatja e kontratave të shërbimeve publike është e kufizuar dhe nuk i kalon dhjetë vjet për shërbimet e transportit rrugor me autobus.

5. Nëse është e nevojshme, duke marrë në konsideratë amortizimin e aseteve, kohëzgjatja e kontratës të shërbimit publik mund të zgjatet maksimumi me 50% nëse operatori i shërbimit publik ofron asete, të cilat janë të rëndësishme në lidhje me asetet e përgjithshme të nevojshme për kryerjen e shërbimeve të transportit të udhëtarëve të mbuluar nga kontrata e shërbimit publik dhe kryesisht me shërbimet e transportit të udhëtarëve të përfshira në kontratë. Nëse justifikohet nga:

a) kostot që rrjedhin nga situata e veçantë gjeografike, kohëzgjatja e kontratave të shërbimit publik e specifikuar në pikën 3, në rajonet/vendet e banuar më të largëta mund të zgjatet për një maksimum prej 50%;

b) amortizimi i kapitalit në mjete lëvizëse lidhur me një infrastrukturë të pazakontë, dhe nëse kontrata e shërbimit publik ka kaluar në procesin e një procedure konkurruese tenderimi të rregullt, një kontratë e shërbimeve publike mund të ketë një kohëzgjatje më të madhe. Për të siguruar transparencë në këtë rast, autoriteti përgjegjës i dërgon Komisionit të Ndihmës Shtetërore, kontratën e shërbimit publik, brenda një viti nga lidhja e saj dhe elementet që justifikojnë kohëzgjatjen e saj.

6. Në zbatimin e kontratave të shërbimit publik, operatorët e shërbimeve publike zbatojnë detyrimet, sipas legjislacionit kombëtar apo marrëveshjeve kolektive, në fushën e së drejtës sociale dhe në fushën e së drejtës së punës.

7. Pa cenuar legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, duke përfshirë marrëveshjet kolektive ndërmjet partnerëve socialë, autoritetet përgjegjëse mund t'i kërkojnë operatorit të përzgjedhur të shërbimit publik që t'i garantojë personelit të punësuar më parë për të ofruar shërbime, të drejtat për të cilat ata do të gëzonin/përfitonin, nëse do të kishte pasur një transferim brenda kuadrit ligjor përkatës, në lidhje me mbrojtjen e punonjësve, të drejtat në rastin e transferimeve të ndërmarrjeve, bizneseve ose pjesëve të ndërmarrjeve ose të bizneseve.

8. Kur autoritetet përgjegjëse kërkojnë që operatorët e shërbimeve publike të respektojnë disa standarde sociale, dokumentet e tenderit dhe kontratat e shërbimit publik do të listojnë personelin

në fjalë dhe do të specifikojnë në mënyrë transparente të drejtat e tyre kontraktuale dhe kushtet, në të cilat konsiderohet se punonjësit janë të lidhur me shërbimet.

9. Kur autoritetet përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkojnë që operatorët e shërbimeve publike të respektojnë disa standarde/kritere cilësore dhe sociale, të cilat do të përfshihen në dokumentet e tenderit dhe në kontratat e shërbimit publik. Duke respektuar legjislacionin, në lidhje me mbrojtjen e punonjësve, të drejtat në rastin e transferimeve të ndërmarrjeve, bizneseve ose pjesëve të tyre, dokumentet e tilla të tenderit dhe kontratat e shërbimit publik, aty ku është e zbatueshme, do të përmbajnë, gjithashtu, informacion mbi të drejtat dhe detyrimet, në lidhje me transferimin e personelit të marrë nga operatori i mëparshëm.

10. Dokumentet e tenderit dhe kontratat e shërbimit publik tregojnë në mënyrë transparente, nëse mund të merret në konsideratë nënkontraktimi, dhe nëse po, deri në çfarë mase. Nëse nënkontraktimi zhvillohet, operatorit të cilit i është besuar administrimi dhe kryerja e shërbimeve të transportit rrugor publik të udhëtarëve, në përputhje me këtë udhëzim, do t'i kërkojë të kryejë vetë pjesën më të madhe të këtyre shërbimeve të transportit të udhëtarëve. Një kontratë e shërbimit publik që mbulon në të njëjtën kohë hartimin, ndërtimin dhe funksionimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve mund të lejojë nënkontraktimin e plotë për funksionimin e këtyre shërbimeve. Kontrata e shërbimit publik përcakton, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar përkatës, kushtet e zbatueshme për nënkontraktimin.

11. Kontratat e shërbimit publik do të kërkojnë që operatori t'i sigurojë autoritetit përgjegjës informacionin thelbësor për dhënien e kontratave të shërbimit publik, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen legjitime të informacionit konfidencial të biznesit/veprimtarisë.

12. Autoritetet përgjegjëse do të vënë në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara informacionin përkatës për përgatitjen e një oferte, sipas një procedure tenderimi konkurruese, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen legjitime të informacionit konfidencial të biznesit/veprimtarisë. Kjo do të përfshijë informacion mbi kërkesën e udhëtarëve, tarifën, kostot dhe të ardhurat, në lidhje me transportin publik të udhëtarëve të mbuluar nga



procedura e tenderit konkurrues dhe detajet e specifikimeve të infrastrukturës përkatëse për funksionimin e mjeteve të kërkuara ose mjeteve lëvizëse për t'u mundësuar palëve të interesuara të mirinformuara të hartojnë planet e biznesit.

Neni 6

Dhënia e kontratave të shërbimit publik

1. Kontratat e shërbimit publik jepen në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim. Megjithatë, kontratat e shërbimit ose kontratat e shërbimit publik, siç janë përcaktuar në kuadrin ligjor për prokurimin publik për shërbimet publike të transportit të udhëtarëve me autobus, do të jepen në përputhje me këtë kuadër ligjor, kur këto kontrata nuk e marrin formën e kontratave të koncesionit për shërbime të tilla, siç përcaktohen në kuadrin ligjor për prokurimin publik. Kur kontratat jepen në përputhje me kuadrin ligjor për prokurimin publik, dispozitat e pikave 2 deri në 6 të këtij neni, nuk zbatohen.

2. Përveç rasteve kur ndalohet nga kuadri ligjor përkatës, çdo autoritet vendor përgjegjës, pavarësisht nëse është apo jo një autoritet individual ose një grup autoritetesh që ofrojnë shërbime të integruara të transportit publik të udhëtarëve, mund:

a) të vendosë të ofrojë vetë shërbimet e transportit publik të udhëtarëve; ose

b) t'i japë kontrata shërbimi publik drejtpërdrejt një entiteti ligjorisht të ndryshëm mbi të cilin autoriteti vendor përgjegjës, ose, në rastin e një grupi autoritetesh, të paktën një autoritet vendor përgjegjës, ushtron kontroll të ngjashëm me atë të ushtruar mbi departamentet e veta.

3. Shërbimi i transportit publik të udhëtarëve ose kontrata e shërbimit publik, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, mund të mbulojë vetëm nevojat e transportit të zonave urbane ose zonave rurale, ose të dyja.

4. Kur një autoritet vendor përgjegjës merr një vendim të tillë, do të zbatohen sa vijon:

a) për të përcaktuar nëse autoriteti vendor përgjegjës ushtron kontroll, merren parasysh faktorë të tillë, si niveli i përfaqësimit në organet administrative, të menaxhimit ose të mbikëqyrjes, saktësime që lidhen me to në statutin e shoqatës, pronësia, si dhe ndikimi dhe kontrolli efektiv mbi vendimet strategjike dhe vendimet individuale të menaxhimit.

b) Në përputhje me të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë, mbajtja 100% e kapitalit nga ana e autoriteteve publike përgjegjëse, veçanërisht në rastin e partneritetit publik-privat, nuk është një kusht detyrues për të vendosur kontrollin sipas kuptimit të këtij paragrafi, për aq sa sektori publik ushtron një ndikim mbizotërues dhe që kontrolli mund të krijohet në bazë të kriterëve të tjera;

c) kushti për zbatimin e këtij paragrafi është që operatori i brendshëm dhe çdo entitet mbi të cilin ky operator ushtron, madje edhe një ndikim minimal, kryejnë veprimtarinë e tyre të transportit të udhëtarëve publik, brenda territorit të autoritetit vendor përgjegjës, pavarësisht nga ndonjë linjë dalëse ose elemente të tjera ndihmëse të këtij aktiviteti, që të hyjë në territorin e autoriteteve përgjegjëse vendore fqinje dhe të mos marrë pjesë në tendera konkurrues, në lidhje me sigurimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve publikë të organizuar jashtë territorit të autoritetit vendor përgjegjës;

d) pavarësisht nga shkronja “b”, një operator i brendshëm mund të marrë pjesë në konkurrim të barabartë në tendera, dy vjet para përfundimit të dhënies së kontratës direkte të shërbimit publik, me kusht që të jetë marrë një vendim përfundimtar që aplikimet për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve, objekt i një kontrate të një operatori të brendshëm në një tender konkurrues të ndershëm dhe që operatorit të brendshëm të mos i jetë dhënë ndonjë kontratë direkte tjetër e shërbimit publik;

e) në mungesë të autoritetit vendor përgjegjës, shkronjat “a”, “b” dhe “c” do të zbatohen nga një autoritet kombëtar që vepron për të mirën e një zonë gjeografike, që nuk është kombëtare, me kusht që operatori i brendshëm të mos marrë pjesë në konkurrim në tenderat në lidhje me shërbimet publike të transportit të udhëtarëve të organizuara jashtë zonës për të cilat është dhënë kontrata shërbimit publik;

f) nëse nënkontraktuesi, sipas nenit 5, pika 7, është përcaktuar, atëherë operatori i brendshëm është i detyruar që të sigurojë vetë pjesën më të madhe të shërbimit publik të transportit të udhëtarëve.

5. Çdo autoritet përgjegjës që i drejtohet një pale të tretë, përveç një operatori të brendshëm, do të japë kontrata për shërbime publike në bazë të një procedure tenderimi konkurrues, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikat 5 dhe 6. Procedura e



miratuar për tenderimin konkurrues do të jetë e hapur për të gjithë operatorët, do të jetë e drejtë dhe do të respektojë parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit. Pas dorëzimit të ofertave dhe çdo parazgjedhjeje, procedura mund të përfshijë negociata, në përputhje me këto parime për të përcaktuar mënyrën më të mirë për të përmbushur kërkesat specifike ose komplekse.

6. Përveç rasteve kur ndalohet nga kuadri ligjor përkatës, autoriteti përgjegjës mund të vendosë të japë kontrata për shërbime publike drejtpërdrejt:

a) kur vlera mesatare vjetore e tyre vlerësohet në më pak se 1 000 000 euro; ose

b) kur ato kanë të bëjnë me ofrimin vjetor të më pak se 300 000 kilometrave të shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve.

7. Në rastin e një kontrate shërbimi publik që i jepet drejtpërdrejt një ndërmarrjeje të vogël ose të mesme, që operon me jo më shumë se 23 mjete rrugore, vlera monetare dhe numri i kilometrave të përmendur më sipër, mund të rriten ose në një vlerë mesatare vjetore të vlerësuar në më pak se 2 000 000 euro ose në një ofrim vjetor me më pak se 600 000 kilometra shërbime të transportit publik të udhëtarëve.

8. Kur autoriteti përgjegjës vendos të japë drejtpërdrejt një kontratë shërbimi publik, ai do të përcaktojë kërkesat e performancës së matshme, transparente dhe të verifikueshme. Kërkesa të tilla do të përfshihen në kontratë. Kontrata do të përfshijë tregues specifikë të performancës që i mundësojnë autoritetit përgjegjës të kryejë vlerësime periodike.

9. Në rast të ndërprerjes së shërbimeve ose rrezikut të menjëhershëm të një situate të tillë, autoriteti përgjegjës mund të marrë masa emergjente, të cilat do të marrin formën e një dhënieje të drejtpërdrejtë ose një marrëveshjeje formale për të zgjatur një kontratë shërbimi publik ose një kërkesë për të ofruar disa detyrime të shërbimit publik. Operatori i shërbimeve publike ka të drejtë ankese kundër vendimit për vendosjen e ofrimit të detyrimeve të caktuara të shërbimit publik. Periudha për të cilën një kontratë shërbimi publike jepet, zgjatet ose vendoset me masa emergjente, nuk duhet të kalojë 2 vjet.

Neni 7

Kompensimi i shërbimit publik

1. Gjithë kompensimi i lidhur me një rregull të përgjithshme ose një kontratë shërbimi publik do të jetë në përputhje me nenin 5, pavarësisht se si është dhënë kontrata.

2. Të gjitha kompensimet e çfarëdo natyre që lidhen me një kontratë shërbimi publik që nuk është dhënë sipas nenit 6(1), (3) ose (4b) ose që lidhet me një rregull të përgjithshme do të jetë, gjithashtu, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në aneksin 1 dhe rekomandimet e dhëna në aneksin 2 (Tabela: Treguesit kryesorë të performancës dhe llojet e kostove).

Neni 8

Publikimi

1. Çdo autoritet përgjegjës bën publik, një herë në vit, një raport të përmbledhur mbi detyrimet e shërbimit publik për të cilat është përgjegjës. Ai raport do të përfshijë datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontratave të shërbimit publik, operatorët e përzgjedhur të shërbimeve publike dhe pagesat e kompensimit dhe të drejtat ekskluzive, që u janë dhënë atyre operatorëve të shërbimeve publike si rimbursim. Raporti mundëson monitorimin dhe vlerësimin e performancës, cilësisë dhe financimit të rrjetit të transportit publik dhe, nëse është e përshtatshme, jep informacion mbi natyrën dhe shtrirjen e çdo të drejte ekskluzive të dhënë. Raporti do të marrë, gjithashtu, në konsideratë objektivat e politikës, siç deklarohen në dokumentet e politikave të transportit publik, kombëtare ose vendore. Autoritetet përgjegjëse do të lehtësojnë aksesin për këto raporte, nëpërmjet një portali/web të përbashkët.

2. Çdo autoritet përgjegjës merr masat e nevojshme, me qëllim që, jo më vonë se një vit përpara lëshimit të ftesës për pjesëmarrje në procedurat e tenderimit, apo një vit para dhënies me procedurë direkte, të publikojë në portal/web, të paktën informacionet e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën e autoritetit përgjegjës;

b) tipi i kontratës që parashikohet të jepet;

c) shërbimet dhe zonat që potencialisht mbulohen nga dhënia e kontratës;

d) datën e parashikuar të fillimit dhe kohëzgjatjen e kontratës së shërbimit publik.



3. Autoritetet përgjegjëse mund të vendosin që të mos publikojnë këto informacione kur një kontratë e shërbimit publik mbulon dhënien më pak se 50 000 km të shërbimeve publike në transportin e udhëtarëve.

4. Nëse këto të dhëna ndryshojnë pas botimit të saj, autoriteti përgjegjës duhet të publikojë një korrigjim sa më shpejt që të jetë e mundur. Ky korrigjim bëhet pa cenuar datën e lëshimit të dhënies direkte apo ftesën për tender. Ky paragraf nuk zbatohet për nenin 6, pika 7.

5. Me kërkesën e çdo pale të interesuar, autoriteti përgjegjës i komunikon arsyet e vendimit të tij që lidhet me dhënien direkte të një kontrate të shërbimit publik.

Neni 9

Periudha kalimtare

1. Kontratat e shërbimit publik jepen në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim. Megjithatë, kontratat e shërbimit ose kontratat e shërbimit publik, siç janë përcaktuar në kontratat e mëparshme për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus jepen në përputhje me procedurat e përcaktuara nga kuadri ligjor për prokurimin, tenderimin dhe/ose konkurrimin, kur këto kontrata nuk e marrin formën e kontratave të koncesionit për shërbime të tilla të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

2. Ky përjashtim nuk zbatohet ndaj operatorëve të shërbimit publik, që sigurojnë shërbime, të cilat janë objekt tenderimi.

3. Kur autoritetet përgjegjëse përdorin opsionin referuar në pikën 1, e zbatojnë pa diskriminim, duke përjashtuar të gjithë operatorët potencialë të shërbimit publik që përmbushin këtë kriter dhe informojnë operatorët potencialë për vendimin e tyre në fillim të procedurës së dhënies së kontratave të shërbimit publik.

4. Ky udhëzim nuk i shtrin efektet mbi licencat e lëshuara nga institucionet përkatëse, qendrore dhe të njësisë të vetëqeverisjes vendore për shërbimet në transportin publik rrugor të udhëtarëve, përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Neni 10

Përputhshmëria me kuadrin ligjor

1. Kompensimi i shërbimit publik për operimin e shërbimeve publike të transportit të udhëtarëve

ose për respektimin e detyrimeve tarifore të hartuara nëpërmjet rregullave të përgjithshme, të paguara në përputhje me këtë udhëzim është në harmoni me tregun e përbashkët.

2. Pa cenuar kuadrin ligjor përkatës, autoriteti përgjegjës mund të vazhdojë të japë ndihma për sektorin e transportit, në pajtim me rregullat me të cilat i plotësojnë nevojat e koordinimit të transporteve ose që i korrespondojnë rimbursimit të disa detyrimeve të qenësishme në konceptin e shërbimit publik, përveç atyre që mbulohen nga ky udhëzim dhe sidomos:

a) deri në momentin e hyrjes në fuqi të rregullave të përbashkëta mbi ndarjen e kostove të infrastrukturës, kur ndihma u jepet operatorëve që duhet të përballojnë shpenzime në lidhje me infrastrukturën që ata përdorin, ndërsa operatorë të tjerë nuk i nënshtrohen një detyrimi të ngjashëm. Për të përcaktuar sasinë e ndihmës të dhënë në këtë mënyrë, është e detyrueshme që të merren parasysh kostot e infrastrukturës që llojet konkurruese të transportit nuk duhet t'i përballojnë;

b) kur qëllimi i ndihmës është të promovojë kërkimin shkencor, ose zhvillimin e sistemeve të transportit dhe teknologjive që janë më ekonomike për komunitetin në përgjithësi.

3. Një ndihmë e tillë do të jetë e kufizuar në fazën e kërkimit dhe të zhvillimit dhe nuk mund të mbulojë shfrytëzimin tregtar të sistemeve dhe të teknologjive të transportit në fjalë.

Neni 11

Raportet

Pas përfundimit të periudhës tranzitore të parashikuar në nenin 9, pika 2, pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore paraqitet një raport, përgatitur nga ministria përgjegjëse për transportin, si dhe nga autoritetet vendore/njësitë e vetëqeverisjes vendore, mbi zbatimin e këtij udhëzimi dhe mbi zhvillimet në ofrimin e shërbimeve publike të transportit të udhëtarëve në linjat dhe zonat përkatëse. Komisioni vlerëson, veçanërisht, zhvillimin e cilësisë së shërbimeve publike të transportit të udhëtarëve dhe efektet e dhënies direkte të këtyre shërbimeve, duke e shoqëruar, në rast se duhet, me propozime për ndryshimin e këtij udhëzimi.



Neni 12

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e udhëzimit

Ky udhëzim i drejtohet dhe u shërben institucioneve qendrore dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore përgjegjëse, të cilat kur vendosin ose kontraktojnë detyrimet e shërbimit publik, kompensojnë operatorët e shërbimit publik për shpenzimet e kryera dhe/ose japin të drejta ekskluzive në këmbim të kryerjes së detyrimeve të shërbimit publik, bazohen në përcaktimet e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

ANEKSI 1
RREGULLAT E ZBATUESHME TË
KOMPENSIMIT NË RASTET QË I
REFEROHEN NENIT 7, PIKA 1

1. Kompensimi lidhur me kontratat e shërbimit publik jepet drejtpërdrejt në përputhje me nenin 6, pikat 2, 4, 5 ose 6, ose i lidhur me një rregull të përgjithshme duhet të llogaritet në bazë të rregullave të përcaktuara në këtë aneks.

2. Kompensimi nuk mund të tejkalojë shumën që i korrespondon efektit financiar neto të barabartë me totalin e efekteve, pozitive ose negative, të përmbushjes së detyrimeve të shërbimit publik në kostot dhe të ardhurat e operatorit të shërbimit publik. Efektet vlerësohen duke krahasuar situatën në të cilën detyrimi i shërbimit publik është përmbushur me situatën që do të ekzistonte nëse nuk do të ishte përmbushur ky detyrim. Për të llogaritur efektin financiar neto, autoriteti përgjegjës udhëhiqet nga skema e mëposhtme:

- kostot në lidhje me detyrimin e një shërbimi publik ose me disa detyrime të shërbimit publik, të vendosura nga autoriteti/autoritetet përgjegjëse e të përfshira në një kontratë publike për shërbime dhe/ose në një rregull të përgjithshme;

- minus efektet pozitive financiare të gjeneruara brenda rrjetit të operuar, sipas detyrimeve të shërbimit publik në fjalë;

- minus të ardhurat nga taksat ose të ardhura të tjera të gjeneruara gjatë përmbushjes së detyrimeve të shërbimit publik në fjalë, plus një fitim i arsyeshëm, barabartë me efektin financiar neto.

3. Përmbushja e detyrimit të shërbimit publik mund të ndikojë në veprimtaritë e transportit të një operatori, të cilat shkojnë përtej detyrimeve të shërbimit publik në fjalë. Për të shmangur kompensimin e tepërt ose moskompensimin, në llogaritjen e efektit financiar neto duhet të merren në konsideratë efektet financiare sasiore në rrjetet e operatorit përkatës.

4. Kostot dhe të ardhurat duhet të llogariten në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe rregullat fiskale në fuqi.

5. Për të rritur transparencën dhe për të shmangur ndërsubvencionet, në rastet kur një operator i shërbimit publik jo vetëm ofron shërbime të kompensuara që u nënshtrohen detyrimeve të shërbimit publik, por, gjithashtu, merr pjesë në veprimtari të tjera, llogaritë e shërbimeve publike në fjalë duhet të jenë të ndara për të përmbushur të paktën kushtet e mëposhtme:

- llogaritë operative që i korrespondojnë secilës prej këtyre veprimtarive duhet të jenë të ndara dhe kuota e aktiveve përkatëse dhe kostot fikse duhet të shpërndahen në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe rregullat fiskale në fuqi;

- në asnjë rast, kostot e ndryshueshme, kontributi i përshtatshëm për kostot fikse dhe fitimi i arsyeshëm, të lidhura me çdo veprimtari tjetër të operatorit të shërbimit publik, në asnjë rrethanë nuk mund t'i ngarkohen shërbimit publik në fjalë;

- kostot e shërbimit publik duhet të balancohen me anë të të ardhurave operative dhe të pagesave nga autoritetet publike, pa mundësinë e transferimit të të ardhurave në një sektor tjetër të veprimtarisë së operatorit të shërbimit publik.

6. “Fitimi i arsyeshëm” nënkupton një normë të kthimit të kapitalit që është e zakonshme për sektorin në një shtet anëtar të caktuar dhe që merr parasysh praninë ose mungesën e riskut të marrë nga operatori i shërbimit publik, për shkak të ndërhyrjes së autoritetit publik.

7. Metoda e kompensimit duhet të nxisë mirëmbajtjen ose zhvillimin e:

- administrimit efikas nga ana e operatorit të shërbimit publik, që mund t'i nënshtrohet një vlerësimi objektiv; dhe



- ofrimit të shërbimeve të transportit të udhëtarëve me standarde mjaftueshëm të larta.

ANEKSI 2

Tabelë. Treguesit kryesorë të performancës (TKP)

Nr.	TKP	Indikatorët/treguesit
1	Udhëtarë-kilometra për mjet-kilometër	Treguesi i ngarkesës mesatare në çdo mjet/autobus
2	Mjet/autobus-kilometër për anëtarët e stafit	Treguesi i mjetit/autobusit për çdo person direkt të punësuar nga operatori dhe jo nga nënkontraktori
3	Të ardhurat nga tarifatat për mjet/autobus-kilometër (euro)	Treguesi i të ardhurave mesatare për çdo mjet/autobus kilometër
4	Kostoja e operimit për mjet/autobus-kilometër (euro)	Treguesi i disa elementeve të kostove ose sigurimin/dhënien e çdo mjet/autobus kilometër
5	Përqindja/pjesa e kostos operative të mbuluar nga tarifatat	Treguesi i përqindjes/pjesës të kostove raportuar si “kosto operuese” të mbuluar nga tarifatat paguar direkt nga udhëtarët
6	Përqindja/pjesa e kostos operative të mbuluar nga subvencioni	Treguesi i përqindjes/pjesës të kostove raportuar si “kosto operuese” të mbuluar nga subvencionet ofruar/dhënë nga ose nëpërmjet një autoriteti përgjegjës
7	Shpejtësia e operimit (kilometra/orë)	Treguesi i shpejtësisë mesatare të shërbimeve publike të udhëtarëve

Lidhur me llogaritjen e pagesave të kompensimit, që përdoren/të parashikuara në kontratat përkatëse (*Gross Cost Contract dhe Net Cost Contract*) të transportit publik të udhëtarëve, rekomandohen të vlerësohen dy lloje kryesore të kostove:

1. Kostoja bruto

a) Operatori paguhet për ofrimin e shërbimeve nga autoriteti përgjegjës, bazuar në një strukturë çmimi të rënë dakord. Vëllimi dhe natyra e shërbimeve është e përcaktuar nga autoriteti përgjegjës. Në kontratat e kostos bruto, udhëtari mund të shihet si klient i autoritetit përgjegjës dhe operatori është nënkontraktor ose agent. Të gjitha të drejtat ndaj klientëve/udhëtarëve, të ardhurat dhe informacioni shoqëruar në përgjithësi u përkasin autoriteteve.

b) Kostoja bruto është mekanizmi më i thjeshtë i kompensimit, ku autoriteti përgjegjës paguan operatorin e shërbimit publik me të gjitha kostot financiare, plus një fitim të arsyeshëm, por ku autoriteti mbledh të ardhurat për funksionimin e shërbimit.

c) Kontratat e kostos bruto përdoren gjerësisht nga autoritetet e transportit në zonat e mëdha urbane, ku biletat, zakonisht të vlefshme për çdo udhëtim brenda një periudhe të caktuar vlefshmërie, nuk janë specifike për një rrugë të veçantë, kontratë shërbimi publik apo edhe një modalitet.

d) Në vend që të shpërndahen të ardhurat në mënyra ose kontrata individuale të shërbimit publik, autoritetet përgjegjëse, në vend të kësaj mund të prokurorjnë shërbimet e transportit, mbi bazën e kostos bruto dhe tarifatat e caktuara, të shesin dhe inspektojnë/kontrollojnë biletat dhe mbajnë vetë të ardhurat.

Disavantazhi i kësaj tip kontrate është se nuk ka nxitje për operatorin e transportit për të zgjeruar shërbimet, të rrisë bazën e klientëve për shërbimet dhe për të ofruar shërbime më të mira. Cilido qoftë niveli i performancës, shumica fikse e paracaktuar duhet të paguhet.

2. Kostoja neto

a) Operatori i shërbimit publik mban të ardhurat nga shitja e biletave. Në kontratën e kostos neto, operatorit të shërbimit publik i paguhet një shumë e rënë dakord mbi bazën e pritshme, diferenca midis të ardhurave dhe kostove totale operative;

b) Të gjitha të ardhurat, informacioni dhe marrëdhënia me klientët/udhëtarët i përkasin operatorit të shërbimit publik. Autoriteti i përgjegjës i transportit përfshihet në një rol shoqëror, si sigurimi i cilësisë së shërbimit ose ofrimi i fondeve të shërbimit për të modifikuar vëllimin, llojin ose çmimin e shërbimeve që ofrohet, i cili do të kishte qenë ndryshe komercialisht;

c) Një sistem kompensimi i kostos neto mund të ndodhë me një operator të brendshëm, që mbledh dhe mban të gjitha të ardhurat e biletave, ose përmes tenderimit konkurrues në të cilin secili ofertues duhet të parashikojë të ardhurat e biletave, si pjesë e procesit të tyre të ofertimit. Prandaj, operatori i shërbimit publik mbart si rrezikun e prodhimit, ashtu edhe rrezikun e të ardhurave;

d) Në rastin e tenderit konkurrues, supozohet se procesi konkurrues nënkupton kompensimin e kërkuar, i cili do të rezultojë në vetëm një “fitim të arsyeshëm”, duke pasur parasysh përfshirjen e një rreziku tregtar, megjithëse autoriteti ruan detyrimin e tij për të siguruar që nuk ekziston asnjë mbikompensim.

e) Në praktikë, shumë kontrata me kosto neto kanë variante të ngjashme me ato për kontratat e



kostos bruto. Çdo rritje e konsiderueshme e të ardhurave mbi objektivin, do të jetë subjekt i një marrëveshje për ndarjen e të ardhurave, në mënyrë që operatori i shërbimit publik të mos marrë përfitime të tepërta të papritura. Disa masa mbrojtëse do të ofrohen nga autoriteti përgjegjës i transportit kundër koston së lartë, shkaktuar kryesisht nga inflacioni, ose ndërprerjet e shërbimit /operimit.

Disavantazhi i kësaj tip kontrate është se autoriteti i le kompetencë operatorit të transportit të gjitha vendimet që lidhen me shërbimin dhe çmimet, por operatori mund të ketë objektiva të ndryshëm nga autoriteti përkatës (qendror, vetëqeverisjes vendore etj.).

Shënim:

1. Llogaritja e koston neto, marzhit të fitimit dhe kontrolli i mbikompensimit kryhet sipas parashikimeve të bëra në kreun III, të VKM-së nr. 650, datë 14.9.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, intensitetit dhe të procedurës për dhënie dhe autorizimin e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe publik”.

2. Referuar pikave 5, 12 dhe 27, në hyrje të rregullores 1370/2007:

- Mekanizmat që mund të përdoren për të garantuar ofrimin e shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve përfshijnë dhënie e:

- i. të drejtave ekskluzive operatorëve të shërbimit publik;

- ii. kompensimeve financiare për operatorët e shërbimit publik dhe përcaktimin e rregullave të përgjithshme për funksionimin e transportit publik, të cilat janë të zbatueshme për të gjithë operatorët;

- Nga pikëpamja e legjislacionit të BE-së, nuk ka rëndësi nëse menaxhimi i shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve bëhet nga ndërmarrjet shtetërore apo private;

- Kompensimi i dhënë nga autoritetet përgjegjëse për të mbuluar koston e përmbushjes së detyrimeve, duhet të llogaritet në mënyrë që të shmangë mbikompensimin. Në rastet kur një autoritet përgjegjës planifikon të lidhë një kontratë publike për shërbime, pa e kaluar atë në proces prokurimi, ai duhet, gjithashtu, të respektojë rregullat e detajuara që garantojnë që shumat e kompensimit të jetë e saktë dhe të pasqyrojë dëshirën për efikasitet dhe cilësi shërbimi.

VENDIM

Nr. 322, datë 14.11.2023

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SHPK, SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 8, 9, pikat 4 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie dhe autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2360/2 prot., datë 9.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Karavasta Solar’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2306 prot., datë 17.10.2023, paraqiti aplikimin për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të palës huamarrëse (shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k.) ndaj Palës Huadhënëse (e përbërë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe Privredna Banka Zagreb – Diončko Društvo), ku shoqëria Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. vepron si Agjenti i Mjeteve të Ekzekutimit të Detyrimeve Onshore, në zbatim të Marrëveshjes për Kushtet e Përbashkëta (nënshkruar më 23.7.2023) dhe Marrëveshjes për



Barrën Siguruese mbi Kuotat (nënshkruar më 13.10.2023).

- Shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 9.5.2022.

- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/ aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/ aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/ eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:

- Neni 8, pika 1, geramat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar.

- Neni 8, pika 2, geramat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar.

- Shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa u përket pagesave rregullatore.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për sa parashikohet në marrëveshjen e barrës siguruese, por dhe për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësojmë që t’i lihet kusht shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. që të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të detyrimit dhe heqjes së barrës siguruese mbi kuotat, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k., si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të saj ndaj Palës Huadhënëse (e përbërë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Korporata Financiare

Ndërkombëtare (IFC), “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. dhe Privredna Banka Zagreb – Diončko Društvo), ku shoqëria “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. vepron si Agjenti i Mjeteve të Ekzekutimit të Detyrimeve Onshore.

2. Dhënia e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “Karavasta Solar” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo të palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të detyrimit dhe heqjes së barrës siguruese mbi kuotat e saj, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Karavasta Solar” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 323, datë 14.11.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 72, DATË 13.3.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SUN AVENUE’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar;



nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 136/12 prot., datë 10.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.3.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sun Avenue’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw””,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 72, datë 13.3.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Sun Avenue” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar, duke i lënë kushtin që të informojë ERE-n çdo 4 (katër) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaiik deri në datën 14.4.2024.

ERE, me shkresën nr. 136/9 prot., datë 16.3.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 72/2023, dhe me shkresën nr. 136/10 prot., datë 16.6.2023, i kujtoi shoqërisë detyrimin për plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s.

Në korrespondencën e zhvilluar me shoqërinë në lidhje me plotësimin e këtij kushti, ajo ka informuar ERE-n se është pajisur me lejen e ndërtimit.

Më tej, në përgjigje të shkresës së ERE-s, të datës 7.11.2023, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2055/9 prot., datë 8.11.2023, shoqëria ka informuar se në fund të muajit tetor 2023 ka filluar fazën e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik.

Me depozitimin e këtij informacioni, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72/2023, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke

përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.3.2023, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Sun Avenue” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 324, datë 14.11.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 73, DATË 13.3.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SUNPOWER 2017’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134/12 prot., datë 10.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit,



Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.3.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sunpower 2017’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw”,”

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 73, datë 13.3.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Sunpower 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar, duke i lënë kushtin që të informojë ERE-n çdo 4 (katër) muaj mbi fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaiik, deri në datën 22.4.2024.

- ERE, me shkresën me nr. 134/9 prot., datë 16.3.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 73/2023 dhe me shkresën me nr. 134/10 prot., datë 16.6.2023, i kujtoi asaj detyrimin për plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s.

- Në korrespondencën e zhvilluar me shoqërinë, në lidhje me plotësimin e këtij kushti, ajo ka informuar ERE-n se është pajisur me lejen e ndërtimit.

- Më tej, në përgjigje të shkresës së ERE-s të datës 7.11.2023, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2056/10 prot., datë 8.11.2023, shoqëria ka informuar se në fund të muajit tetor 2023 ka filluar fazën e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik.

- Me depozitimin e këtij informacioni, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2023, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2023 shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Sunpower 2017” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 354, datë 1.12.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRINI BULQIZE” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “POLEMI”

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2417/1 prot., datë 24.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”,”

konstatoi se:



- Shoqëria “Drini Bulqize” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417 prot., datë 17.11.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, në pellgun ujëmbledhës mbi tri degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Në formatin e aplikimit, shoqëria ka plotësuar kapacitetin e instaluar të HEC-it prej 2 mw, ndërsa në kontratën me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kapaciteti është 1.751 kw, ndaj, nëse subjekti nuk dokumenton ndryshe, ERE, në këtë procedurë, do të marrë në konsideratë kapacitetin prej 1.751 kw, sipas kontratës së nënshkruar me MIE-n.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Drini Bulqize” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 1.2, gerrat “a”, “c” dhe “d”.

- Rezulton se janë depozituar në formatin fotokopje dokumentet e listuara në vijim, ndaj në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të rregullores, duhet të depozitohen në formatin origjinal/fotokopje e njësuar me origjinalin, dokumentet e mëposhtme:

- Kontrata për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC “Polemi”, e nënshkruar me MIE-n;

- Shkresa dhe marrëveshja me OSSH sh.a. për miratimin në parim të pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes;

- Marrëveshja e nënshkruar me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Dibër;

- VNM paraprake.

- Po ashtu, nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacion në vijim:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2. “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Germa “b”: Të depozitohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorin e saj.

Pika 1.3. “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Germa “a”: Të raportohet mbi vlerën e debisë së pashlyer ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Dibër, sipas Marrëveshjes për Pagesën me Këste të Detyrimeve Tatimore, të nënshkruar me këtë të fundit dhe, në rast se është shlyer i tërë detyrimi, duhet të depozitohet vërtetimi që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore, ashtu edhe ndaj atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores.

- Germa “b” dhe “c”. Referuar deklaratës së shoqërisë se hidrocentrali është ndërtuar, duhet të depozitohet informacion mbi mënyrën e financimit të ndërtimit të tij.

Pika 2 “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

2.1. Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- germa “a”: Saktësimet përkatëse në formatin e aplikimit sa u takon njërive gjeneruese dhe kapacitetit të secilës njësi, sipas përcaktimeve në kontratën me MIE-n, si dhe të plotësuar datën e fillimit të operimit.

- Germa “d”: Informacion mbi aplikimin për rinovimin e lejes për përdorimin e burimit ujor e nëse është pajisur me lejen e rinovuar, ta depozitojë atë në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1,751 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqize” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 357, datë 1.12.2023

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT
QË KONTROLLON INTERESAT E
SHOQËRISË “ENERGY FINANCING
TEAM TIRANA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pikat 4 dhe 5, dhe 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2195/6 prot., datë 22.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Energy Financing Team Tirana’ sh.p.k., për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 127, datë 31.5.2022 dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 31.5.2022. Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2195 prot., datë 26.9.2023 dhe nr. 2196 prot., datë 26.9.2023, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që

kontrollon interesat e kësaj shoqërie, për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 100 % të kuotave të zotëruara nga ortakut “EFT International Investments Holdings LTD” sh.p.k. tek “EFT Investments Limited”.

- Për të sqaruar dokumentacionin e konstatuar të munguar të këtij aplikimi, me shkresën nr. 2195/2 prot., datë 13.10.2023, ERE i njoftoi shoqërisë këtë dokumentacion dhe e ftoi në një seancë dëgjimore në datën 20.10.2023, e cila u zhvillua në datën 6.11.2023, pas kërkesës së paraqitur nga përfaqësuesit e shoqërisë, me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 2195/3 prot., datë 18.10.2023, për shtyrjen e datës së zhvillimit të kësaj seance.

- Pas sqarimeve të dhëna në seancë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2195/4 prot., datë 6.11.2023, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë është depozituar dhe dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi.

- Duke qenë se marrëveshja për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. është nënshkruar përpara marrjes së autorizimit të ERE-s, nga ana e shoqërisë është depozituar dhe deklarata, ku, ndër të tjera, përcaktohet se marrëveshja nuk ka kurrësi për qëllim rënien ndesh me rregullat e lidhura me dy licencat e shoqërisë e, po ashtu se, shoqëria dhe grupi EFT angazhohen të nënshkruajnë, depozitojnë, regjistrojnë dhe kryejnë çdo veprim të nevojshëm për rikthimin e strukturës së ortakërisë në gjendjen para nënshkrimit të Marrëveshjes, në rast se kjo gjë do të jetë e nevojshme, si dhe për të respektuar të gjitha kushtet e licencave të lëshuara nga ERE.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., bëhet “EFT Investments Limited”.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT
TË DEKLASIFIKUAR “SEKRET
SHTETËROR” NË DREJTORINË
E PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE**

Bazuar në ligjin nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, i mbledhur më datë 22.12.2023, vendosi të deklasifikojë

informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

1. Deklasifikohen plotësisht informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

Fondi 14/STR

Viti 1988

Niveli i klasifikimit “Sekret”

Dosja nr. 1103. Njoftim i Kryeministrit pa nr. prot., datë 9.2.1988.

Dosja nr. 1106. Njoftime të Bankës së Shtetit nr. 63 prot., datë 13.1.1988, nr. 239 prot., datë 4.2.1988, nr. 533 prot., datë 5.3.1988, nr. 791 prot., datë 5.4.1988, nr. 1041 prot., datë 6.5.1988, nr. 2913 prot., datë 5.12.1988, nr. 121 prot., datë 16.1.1989.

Dosja nr. 1107. Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 1726 prot., datë 14.2.1989.

Dosja nr. 1113. Njoftim i Komisionit të Planit të Shtetit nr. 73 prot., datë 4.2.1989.

Dosja nr. 1117. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 600 prot., datë 8.4.1988.

Dosja nr. 1119. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 681 prot., datë 7.6.1988.

Dosja nr. 1120. Informacion i Komitetit të Partisë Rajonit nr. 2, Tiranë, nr. 628 prot., datë 17.6.1988.

Dosja nr. 1127. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 536 prot., datë 23.3.1988.

Dosja nr. 1130. Njoftim Ministrisë së Financave nr. 518 prot., datë 25.2.1989.

Dosja nr. 1131. Informacion i Komitetit të Partisë të Kombinatit Metalurgjik nr. 210 prot., datë 14.6.1988.

Dosja nr. 1132. Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 2992/1 prot., datë 4.4.1988.

Dosja nr. 1134. Informacion i Komitetit të Partisë Berat nr. 1188 prot., datë 7.9.1988, Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1194 prot., datë 13.9.1988.

Dosja nr. 1135. Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 1513 prot., datë 5.11.1988.

Dosja nr. 1136. Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 2988/1 prot., datë 4.4.1988, Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 1116/1 prot., datë 14.6.1988. Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 6241 prot., datë 27.7.1988.



Dosja nr. 1137. Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 5029/1 prot., datë 14.6.1988.

Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 5030/1 prot., datë 14.6.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 1513 prot., datë 5.11.1988.

Dosja nr. 1138. Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 5029/1 prot., datë 14.6.1988.

Dosja nr. 1140. Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 1165 prot., datë 6.2.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Pukë nr. 281/1 prot., datë 10.5.1988.

Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 6386 prot., datë 4.8.1988.

Dosja nr. 1144. Informacion i Komitetit të Partisë Fier nr. 487 prot., datë 4.3.1988.

Dosja nr. 1145. Informacion i Komitetit të Partisë Patos nr. 230 prot., datë 8.4.1988.

Dosja nr. 1159. Informacion i Hetuesisë së Përgjithshme nr. 1138 prot., datë 17.9.1988. Informacion i Ministrisë së Energjetikës nr. 1140/1 prot., datë 16.3.1988.

Dosja nr. 1162. Informacion i Ministrisë së Energjetikës nr. 7918/1 prot., datë 30.1.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 827 prot., datë 27.4.1988.

Informacion i Komisionit të Planit të Shtetit pa nr. prot., datë 21.7.1988.

Informacion i Hetuesisë së Përgjithshme nr. 1139 prot., datë 17.9.1988.

Dosja nr. 1166. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 198 prot., datë 16.2.1988.

Dosja nr. 1171. Informacion i Hetuesisë së Përgjithshme nr.11 prot., datë 9.1.1988.

Dosja nr. 1178. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 434/1 prot., datë 2.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 1565 prot., datë 31.8.1988.

Dosja nr. 1179. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 1967/1 prot., datë 18.11.1988. Korrespondencë e Komitetit Qendror me Komitetin e Partisë Durrës nr. 6825/2 prot., datë 21.2.1989.

Dosja nr. 1185. Informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave nr. 6386 prot., datë 4.8.1988.

Dosja nr. 1187. Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 562 prot., datë 9.5.1988.

Dosja nr. 1190. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 703 prot., datë 31.12.1987.

Dosja nr. 1193. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1232 prot., datë 20.9.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1527 prot., datë 6.12.1988.

Dosja nr. 1194. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 2022 prot., datë 17.11.1988.

Dosja nr. 1195. Informacion i Hetuesisë së Përgjithshme nr. 1104 prot., datë 12.9.1988.

Dosja nr. 1198. Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 310/1 prot., datë 22.2.1988.

Dosja nr. 1203. Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 264/1 prot., datë 19.2.1988.

Dosja nr. 1206. Informacion i Komitetit të Partisë Vlorë nr. 1295/1 prot., datë 15.10.1988.

Dosja nr. 1217. Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 187 prot., datë 1.2.1988.

Dosja nr. 1218. Informacion i Komitetit të Partisë Krujë nr. 1064 prot., datë 26.11.1988.

Dosja nr. 1220. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 86 prot., datë 26.1.1988.

Niveli i klasifikimit “T. sekret”

Dosja nr. 1221. Informacion i Komitetit të Partisë Kukës nr. 1736 prot., datë 3.5.1988.

Niveli i klasifikimit “Sekret”

Dosja nr. 1223. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1236 prot., datë 21.9.1988.

Dosja nr. 1224. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 508 prot., datë 29.4.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 680 prot., datë 2.5.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tepelenë nr. 316 prot., datë 27.5.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Berat nr. 762 prot., datë 28.5.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Lushnjë nr. 426 prot., datë 28.5.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Krujë nr. 417 prot., datë 25.5.1988.

Dosja nr. 1230. Informacion i Komitetit të Partisë Berat nr. 1293 prot., datë 27.9.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Dibër nr. 765 prot., datë 18.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 1501 prot., datë 22.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 1102 prot., datë 20.8.1988.



Informacion i Komitetit të Partisë Fier nr. 1645 prot., datë 13.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Gramsh nr. 638 prot., datë 21.9.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Kolonjë nr. 425 prot., datë 2.9.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Kukës nr. 777 prot., datë 27.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Lushnjë nr. 685 prot., datë 17.8.1988.

Dosja nr. 1231. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Informacion i Komitetit të Partisë Pogradec nr. 565 prot., datë 30.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Sarandë nr. 761 prot., datë 28.9.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1053 prot., datë 15.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 1233 prot., datë 24.9.1988.

Dosja nr. 1232. Informacion i Komitetit të Partisë Berat nr. 1656 prot., datë 24.12.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Fier nr. 2446 prot., datë 30.12.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Kukës nr. 1045 prot., datë 9.12.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Lushnjë nr. 1070 prot., datë 28.12.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Pogradec nr. 823 prot., datë 23.12.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1528 prot., datë 6.12.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tepelenë nr. 677 prot., datë 10.12.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 1523 prot., datë 29.12.1988.

Dosja nr. 1233. Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 1250 prot., datë 1.10.1988.

Dosja nr. 1241. Informacion i Komitetit të Partisë Krujë nr. 725 prot., datë 23.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 1723 prot., datë 23.9.1988.

Dosja nr. 1253. Njoftim pa nr. prot., datë 27.8.1988, si dhe studim pa nr. prot., datë 14.8.1988, të Këshillit të Ministrave.

Dosja nr. 1257. Njoftim i Këshillit të Ministrave nr. 10 prot., datë 18.2.1988.

Dosja nr. 1258. Informacion i Komitetit të Partisë Sarandë nr. 571 prot., datë 14.7.1988.

Dosja nr. 1261. Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 213 prot., datë 1.2.1988.

Dosja nr. 1263. Informacion i Komisionit të Kontrollit të Shtetit nr. 93 prot., datë 24.2.1988, dosja nr. 1265. Informacion i Komitetit të Partisë Dibër nr. 1005 prot., datë 10.11.1988.

Dosja nr. 1267. Informacion i Komitetit të Partisë Berat nr. 758 prot., datë 25.5.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 499 prot., datë 21.3.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Sarandë nr. 408 prot., datë 24.5.1988.

Dosja nr. 1268. Informacion i Komisionit të Planit të Shtetit pa nr. prot., datë 5.9.1988.

Dosja nr. 1269. Informacion i Ministrisë së Shëndetësisë nr. 605/2 prot., datë 16.2.1988. Informacion i Ministrisë së Shëndetësisë nr. 605/13 prot., datë 15.4.1988.

Informacion i Ministrisë së Shëndetësisë nr. 605/41 prot., datë 22.7.1988.

Dosja nr. 1270. Informacion i Komitetit të Partisë Dibër nr. 763 prot., datë 18.8.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 718 prot., datë 14.6.1988.

Dosja nr. 1272. Informacion i Komitetit të Partisë Berat nr. 115 prot., datë 1.2.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Dibër nr. 538 prot., datë 30.5.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 498 prot., datë 21.3.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Kukës nr. 466 prot., datë 27.5.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 660 prot., datë 24.5.1988.

Dosja nr. 1274. Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 649/1 prot., datë 3.6.1988.

Dosja nr. 1278. Informacion i Prokurorisë së Përgjithshme nr. 163/3 prot., datë 25.11.1988.

Dosja nr. 1282. Informacion i Komitetit të Partisë Dibër nr. 553 prot., datë 1.6.1988.

Dosja nr. 1284. Informacion i Komitetit të Partisë Kolonjë nr. 191 prot., datë 21.4.1988.

Dosja nr. 1285. Informacion i Drejtorisë së Statistikës pa nr. prot., datë 6.4.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 1972 prot., datë 8.11.1988.

Dosja nr. 1298. Informacion i Komitetit të Partisë Fier nr. 837 prot., datë 20.4.1988.

Dosja nr. 1301. Informacion i Komitetit të Partisë Vlorë nr. 1401 prot., datë 12.11.1988.

Dosja nr. 1303. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 257 prot., datë 16.2.1988.



Informacion i Komitetit të Partisë Mat nr. 693 prot., datë 5.9.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 210 prot., datë 23.2.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 485 prot., datë 22.4.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 991 prot., datë 26.7.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1084 prot., datë 26.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1390 prot., datë 28.10.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1478 prot., datë 28.11.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 606 prot., datë 19.5.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 998 prot., datë 27.7.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 1338 prot., datë 26.10.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tropojë nr. 53 prot., datë 19.5.1988.

Dosja nr. 1304. Informacion i Komitetit të Partisë Kukës nr. 652 prot., datë 25.8.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Tiranë nr. 950 prot., datë 13.7.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 779 prot., datë 16.6.1988.

Dosja nr. 1319. Relacion i Këshillit të Ministrave pa nr. prot., datë 28.5.1988.

Dosja nr. 1325. Informacion i Komitetit të Partisë Fier nr. 1566/1 prot., datë 19.10.1987. Informacion i Komitetit të Partisë Gramsh nr. 613 prot., datë 28.10.1987.

Informacion i Komitetit të Partisë Gjirokastrë nr. 500/2 prot., datë 17.10.1987.

Informacion i Komitetit të Partisë Kukës nr. 669/1 prot., datë 23.10.1987.

Informacion i Komitetit të Partisë Lushnjë nr. 876 prot., datë 20.10.1987, dosja nr. 1326. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

Dosja nr. 1326. Informacion i Komitetit të Partisë Shkodër nr. 1415 prot., datë 29.10.1987.

Informacion i Komitetit të Partisë Tepelenë nr. 483/1 prot., datë 21.10.1987.

Informacion i Komitetit të Partisë Vlorë nr. 1459 prot., datë 26.10.1987.

Dosja nr. 1332. Studim i Këshillit të Ministrave pa nr. prot., datë 19.3.1988.

Niveli i klasifikimit “T. sekret”

Dosja nr. 1334. Studim i Sektorit Ekonomik të Komitetit Qendror pa nr. prot., datë 12.12.1988.

Niveli i klasifikimit “Sekret”

Dosja nr. 1336. Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 317 prot., datë 10.2.1988.

Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 317/1 prot., datë 10.3.1988.

Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 317/2 prot., datë 12.4.1988, dërguar Komitetit Qendror, Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 317/3 prot., datë 12.5.1988,

Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 317/4 prot., datë 10.6.1988.

Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 317/5 prot., datë 9.7.1988.

Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 317/6 prot., datë 10.8.1988.

Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 317/9 prot., datë 11.10.1988.

Dosja nr. 1344. Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 563 prot., datë 10.3.1988.

Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 2172 prot., datë 18.8.1988.

Dosja nr. 1351. Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 1486 prot., datë 3.11.1987.

Dosja nr. 1353. Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 600 prot., datë 21.3.1988 dhe nr. 1665 prot., datë 16.9.1988.

Dosja nr. 1354. Informacion i Komitetit të Partisë Kolonjë nr. 90 prot., datë 10.2.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Tropojë nr. 386 prot., datë 10.5.1988.

Dosja nr. 1355. Informacion i Komitetit të Partisë Berat nr. 77 prot., datë 21.1.1988. Informacion i Komitetit të Partisë Dibër nr. 81 prot., datë 23.1.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Durrës nr. 97 prot., datë 25.1.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Elbasan nr. 71 prot., datë 16.1.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Fier nr. 1165 prot., datë 13.6.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Gramsh nr. 45 prot., datë 13.1.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Kolonjë nr. 256 prot., datë 3.6.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Krujë nr. 30 prot., datë 14.1.1988.



Informacion i Komitetit të Partisë Librazhd nr.
36 prot., datë 16.1.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Librazhd nr.
28 prot., datë 16.1.1988.

Informacion i Komitetit të Partisë Lushnjë nr.
342 prot., datë 20.4.1988.

2. Një kopje e bibliografisë t'i dërgohet AKSIK-së, QBZ-së për botim në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të internetit të DPA-së.

KRYETAR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

KËRKESE

Shtetasja Bardhe Preni kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë shpalljen e zhdukjes së shtetasit Anton Simon Preni, më datë 5.8.2012, i lindur më 3.9.1963.

KËRKUESE
Bardhe Preni

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë